



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.187/1 Prot.

Tiranë, më 06 / 02 / 2019

V E N D I M

Nr. 22 , Datë 06 / 02 / 2019

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.147, datë 18.09.2018, të znj.E. M, kundër Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të bindjeve fetare¹*” dhe të “*përgjegjësisë prindërore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.E. M me Urdhërin nr.372 prot., datë 14.12.2016 është emëruar në pozicionin “Psikologe” pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”. Me shkresën me nr.372/1 prot., datë 14.12.2016 i është lidhur kontratë pune me afat 3-mujor, në periudhë prove. Pas kalimit të periudhës së provës, me shkresën me nr.71/3 prot., datë 15.03.2017 i është lidhur kontrata e punës me afat të caktuar (një vjeçar). Me shkresën me nr.192 prot., datë 06.08.2018 ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Znj.E. M parashtron se për periudhën 07.08.2017-07.07.2018 ka qenë me raport me leje barrë lindjeje³ dhe sapo ka përfunduar lejen është kthyer në punë, kur dhe ka marrë njoftimin për

¹ Znj.E. M është praktikante e besimit mysliman dhe mban mbulesë.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

lirim nga detyra. Ankuesja shprehet se nuk ka patur dijë se kontrata e saj e punës ka qenë me afat një vjeçar dhe se nuk ka qenë e firmosur prej saj, prandaj ka bindjen se mund të jetë larguar nga puna për shkak të paragjykitimit për besimin fetar dhe për mbulesën e saj. Më tej në ankesën e saj znj.M citon se: “...Drejtoresha ka shpërdoruar detyrën dhe më ka diskriminuar vetëm për faktin se unë nuk bëhesha pjesë e vjedhjeve dhe abuzimeve, lidhur me ndihmat që vinin në qendër, pasi në çdo rast kutitë, pakot e ndihmave hapeshin, merreshin çfarë i interesonte drejtoreshës dhe çfarë mbetej u jepej personave në qendër”.

Në përfundim të ankesës së saj ankuesja kërkon konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve të saj fetare dhe të përgjegjësisë prindërore, nga ana e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, Tiranë dhe rikthimin e saj në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

³ Bazuar në Vërtetimin e datës 07.08.2018 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën me nr.1267/1 prot., datë 02.10.2018 i është kërkuar informacion Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, lidhur me pretendimin e znj.E. M, duke kërkuar specifikisht:

- Parashtrime lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të kontratave të punës së ankueses.
- Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar shkresërisht (në rrugë administrative) largimin nga puna apo diskriminimin ndaj saj për shkaqet sipërcituar. Nëse po, një kopje të shkresës së ankueses, si dhe të shkresës kthim përgjigje nga ana e Juaj.
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me largimin nga puna të znj.E. M.
- Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar gjyqësisht atë. Nëse po, një kopje të aktit. (kërkesë padisë).
- Informacion mbi numrin e punonjësve psikologë në këtë qendër.
- Informacion mbi numrin e punonjësve të punësuar në të njëjtën periudhë kohore me ankuesen , me kontrata një vjeçare. Një kopje e emërimeve për secilin rast)
- Informacion mbi numrin e punonjësve të larguar pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratës një vjeçare. (Një kopje të procedurës për secilin rast)
- Informacion mbi numrin e punonjësve të cilëve iu është rinovuar kontrata pas përfundimit të afatit një vjeçar, si dhe parashtrime mbi arsyet e rinovimit. (Kopje e procedurës për secilin rast).
- Informacion nëse në pozicionin e znj.E. M është emëruar një punonjës/e tjetër. Nëse po, një kopje të procedurës së marrjes në punë si dhe kopje të dosjes personale të punonjësit të emëruar në pozicionin e ankueses

Me shkresën me nr.248 prot., datë 23.10.2018⁵ Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, ka dërguar një kopje të dokumentacionit të dosjes personale të znj.E. M dhe ka informuar Komisionerin se: *“Punonjësja E. M me Urdhërin nr.372 prot., datë 14.12.2016 është emëruar në pozicionin “Psikologe” pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë dhe ka lidhur një kontratë pune me afat 3 mujor, periudhë e cila konsiderohet periudhë prove. Pas kalimit të periudhës së provës, me pëlqimin e të dyja palëve i është lidhur kontrata individuale e punës me afat të caktuar (një vjeçare), kontratë e cila përfundonte në datën 15.03.2018. Por, për shkak se znj.E. M ka qenë me raport mjekësor “Leje lindje”, ju bëjmë me dije se, mbështetur në pikën 11.2 të kontratës së punës, e cila thotë se, kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, dhe të pikës 12.1/a, e cila ka përcaktuar se kontrata mund të zgjidhet me mbarimin e afatit kur është caktuar në kontratë, asaj i është zgjidhur kontrata pasi i ka përfunduar afati një vjeçar. Përsa i përket pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve fetare, ju*

⁵ Protokolluar me Tonën me nr.1267/2 prot., datë 25.10.2018.

informojmë se e kemi respektuar besimin e saj fetar duke i vënë në dispozicion kohën dhe vendin që ajo të kryejë ritet e veta fetare pa u paragjykuar nga asnjë punonjës në qendrën tonë. Kjo provohet edhe me faktin se znj.E. M i është rinovuar kontrata e punës nga 3-mujore në kontratë me afat një vjeçar. Ndërsa, përsa i përket pretendimeve të saj për pjesën e abuzimit që bëhet në qendrën tonë, jemi të hapur ndaj çdo lloj verifikimi”.

1. Në zbatim të Urdhërit nr.226, datë 15.11.2018 të Komisionerit, me datë 21.11.2018, pranë ambjenteve të Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, u realizua inspektimi i cili kishte si objekt të tij⁶ marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë nga punëdhënësi si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Grupi i inspektimit të KMD-së u takua me: Znj.A.B, me detyrë Drejtore e Qendrës, znj.A.B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Social, znj.SH.M, me detyrë Operatore Sociale dhe znj.I.B me detyrë Punonjëse Sociale.

Gjatë inspektimit u mor në cilësi prove dokumentacioni i kërkuar si dhe nga ana e përfaqësuesve të kësaj qendre u pasqyrua situata si më poshtë citohet⁷:

“Për të gjithë punonjësit e qendrës është aplikuar e njëjta procedurë për punësimin e tyre: të gjithë, fillimisht janë emëruar me kontrata të përkohshme 3 mujore, (periudha e provës) dhe më pas kanë nënshkruar kontrata me afat një vjeçare. Në qendër janë të emëruar aktualisht 4 psikologë, duke përfshirë edhe Përgjegjësen e Sektorit Social. Lidhur me faktin e mos rinovimit të kontratës së punës, në përfundim të afatit të caktuar një vjeçar, përfaqësuesit e qendrës sqaruan se shkaqet që kanë ndikuar në këtë fakt nuk kanë të bëjnë aspak me bindjet e saj fetare apo përgjegjësinë prindërore, pasi në qendër ka dhe punonjës të tjerë që kanë fëmijë minorene (punonjësja M.V, psikologe, ka një fëmijë të moshës 1 vjeç A.B psikologe, ka fëmijë të moshës 3 vjeç), me aftësi të kufizuar; por vetëm me performancën e saj jo të mirë në punë. Drejtorja citon se znj.E.M personalisht i ka kërkuar asaj të mos e angazhojë me punë në terren, për shkak se bashkëshorti nuk ishte dakort me këtë fakt. Por, Drejtorja theksoi se puna e psikologut në këtë

⁶ Informimin mbi numrin e punonjësve psikologë në këtë qendër.

Informimin mbi numrin e punonjësve të punësuar në të njëjtën periudhë kohore me ankuesen , me kontrata një vjeçare. (Një kopje e emërimeve për secilin rast)

Informimin mbi numrin e punonjësve të larguar pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratës një vjeçare. (Një kopje të procedurës për secilin rast)

Informimin mbi numrin e punonjësve të cilëve iu është rinovuar kontrata pas përfundimit të afatit një vjeçar, si dhe parashtrime mbi arsyet e rinovimit. (Kopje e procedurës për secilin rast).

Marrjen e informacionit nëse në pozicionin e znj.E. M është emëruar një punonjës/e tjetër. Nëse po, një kopje të procedurës së marrjes në punë si dhe kopje të dosjes personale të punonjësit të emëruar në pozicionin e ankueses.

Si dhe marrjen e çdo informacioni apo dokumentacioni tjetër që vlerësohet si i nevojshëm për sqarimin sa më të plotë të çështjes.

⁷ Referuar procesverbalit të inspektimit, depozituar në dosjen e subjektit ankues.

qendër zhvillohet kryesisht në terren. Në total nga 18 punonjës që ka qendra, 9 prej tyre janë me fëmijë nga mosha 3 muaj e lart⁸”.

Inspektorët e KMD-së verifikuan ambientin e vënë në dispozicion për kryerjen e ritualeve fetare brenda qendrës, gjë të cilën e konfirmoi edhe znj.I.B, me pozicion Punonjëse Sociale pranë kësaj qendre. Ajo pohoi para inspektorëve se së bashku me znj.E. M kanë kryer ritualin e faljes, bazuar në besimin e tyre fetar dhe se asnjëherë nuk janë paragjykuar apo penguar nga ana e stafit apo Drejtores lidhur me këtë fakt, përkundrazi janë ndihmuar. Përgjegjësja e Sektorit Social theksoi faktin që ata e kanë toleruar maksimalisht ankuesen sa herë që ka kërkuar leje në punë (për vete, për fëmijët dhe për familjarët), dokumentuar ky fakt me mesazhet e printuara, ku reflektohet qartazi ky fakt dhe se diskriminimi i pretenduar nga ana e saj nuk qëndron.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së znj.E. M, Komisioneri me datë 17.12.2018 realizoi një seancë dëgjimore⁹.

Seanca u zhvillua në mungesë të subjektit ankues dhe me praninë e përfaqësuesve të Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë¹⁰.

Përfaqësuesit e Qendrës u qëndruan të njëjtave parashtrime të paraqitura dhe shkresërisht dhe theksuan faktin se janë paraqitur në seancë vetëm për t’u ballafaquar ballë për ballë me ankuesen, lidhur me këto pretendime të saj dhe se me të janë treguar përherë korrekt dhe dashamirës si në aspektin zyrtar dhe atë njerëzor.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë të ankueses nga ana e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, sa i takon bindjeve të saj fetare dhe përgjegjësisë prindërore.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se subjekti ankues, znj.E. M me Urdhërin nr.372 prot., datë 14.12.2016 është emëruar në pozicionin “Psikologe” pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”. Me shkresën me nr.372/1 prot., datë 14.12.2016 i është lidhur kontratë pune me afat 3-mujor, në periudhë prove. Pas kalimit të periudhës së provës, me shkresën me nr.71/3 prot., datë 15.03.2017 është lidhur kontrata e punës me afat të caktuar (një vjeçar). Me shkresën me nr.192 prot., datë 06.08.2018 ankuesja është

⁸ Lista emërore e punonjësve duke specifikuar numrin e fëmijëve dhe moshën respektive të tyre ndodhet e depozituar në dosjen e subjektit ankues.

⁹Referuar shkresës nr.1267/3 prot., datë 13.12.2018, të Komisionerit.

¹⁰ Në seancë morën pjesë Drejtorja e Qendrës znj.A. B dhe juristi i saj, z.A. A.

njoftuar nga punëdhënësi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Znj.E. M parashton se për periudhën 07.08.2017-07.07.2018 ka qenë me raport me leje barrëindjeje¹¹ dhe sapo ka përfunduar lejen është kthyer në punë, kur dhe ka marrë njoftimin për lirim nga detyra.

Komisioneri përgjatë hapave proceduralë të ndjekur për hetimin e kësaj çështjeje, ka verifikuar procedurën e ndjekur nga ana e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, lidhur me pretendimin e ankueses për trajtim të pabarabartë të saj për dy shkaqet e pretenduara: bindje fetare dhe përgjegjësi prindërore, sa i takon largimit nga puna.

Nga këqyrja organikës së Qendrës dhe dosjeve personale të punonjësve rezulton se, aktualisht janë të emëruar 4 psikologë (Përgjegjësja e Sektorit Social dhe 3 psikologë).

- Znj.A. B është Përgjegjësja e Sektorit Social dhe është emëruar në vitin 2015 dhe aktualisht.
- Znj.K. L është psikologe pranë këtij sektori dhe është emëruar në vitin 2012 dhe aktualisht.
- Z.A. M është psikolog dhe është emëruar në vitin 2016 dhe aktualisht.
- Znj.M. V është psikologe dhe është emëruar në vend të subjektit ankues në datën 20.09.2018¹². (Është emëruar në periudhë prove, me kontratë me afat 3 mujor).

Nga këqyrja e dosjeve personale të 4 (katër) psikologëve të Sektorit Social pranë kësaj Qendre, (përfshirë edhe subjektin ankues) rezulton se për të gjithë është ndjekur e njëjta procedurë për marrjen e tyre në punë: fillimisht kanë nënshkruar kontrata 3 mujore (në periudhë prove) dhe më pas janë nënshkruar kontrata 1 vjeçare.

Po ashtu, nga këqyrja e performancave të dy viteve të fundit¹³ të punonjësve sipërcituar dhe të subjektit ankues, konstatohet se, tre punonjësit A.B, K.L, A.M (pa përfshirë psikologun që ka zëvendësuar ankuesen, pasi është në periudhë prove) kanë patur performancë shumë të mirë në punë, pasi rezultojnë me vlerësim “shumë mirë” për secilën nga 15 rubrikat e formularit; ndërsa subjekti ankues rezulton me vlerësim “mirë” për 3 nga rubrikat, “mjaftueshëm” për 7 nga rubrikat dhe “dobët” për 5 nga rubrikat.

Siç shihet, subjekti ankues ka patur performancë më të dobët në punë, krahasuar me psikologët e tjerë, të punësuar pranë kësaj Qendre. Nisur nga ky fakt, Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit nuk ka trajtim të pabarabartë të ankueses sa i takon vendimit për mos rinovim të kontratës, pasi ai nënshkrimin e kontratave të reja (pas përfundimit të afatit një vjeçar të atyre

¹¹ Bazuar në Vërtetimin e datës 07.08.2018 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

¹² Referuar shkresës me nr. 226 prot., datë 20.09.2018.

¹³ Treguesit mbi të cilët mbështetet vlerësimi i performancës së tyre bazohet në 15 rubrika¹³ të specifikuar veçmas secila dhe vlerësimi mund të jetë: “shumë mire”, “mire”, “mjaftueshëm” dhe “dobët”.

aktuale) e ka bazuar në vlerësimin e performancës së secilit, rast pas rasti. Pra, nisur nga ky fakt vlerësimi i punëdhënësit për rinovim ose jo të kontratës së punës me punonjësit, bazuar në performancën e tyre, është tagër i tij dhe në rastin konkret duket të jetë objektiv dhe i paanshëm. Për sa kohë nuk provohet trajtimi i pa barabartë i ankueses nga ana e punëdhënësit, nuk merren në konsideratë as shkaqet për të cilat ajo pretendon diskriminim.

Megjithatë, rezulton e provuar nga dokumentacioni i depozituar në dosje se:

- Emërimi i znj.E. M si psikologe pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, në periudhë prove është bërë nga drejtoresha e kësaj qendre, znj.A. B. (Shkresa me nr.372 prot., datë 14.12.2016)
- Emërimi i znj.E. M si psikologe pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, me afat një vjeçar është bërë po nga znj.A. B në detyrën e drejtoreshës së qendrës.
- Urdhëri për lirimin nga detyra e znj.E. M është bërë po nga e njëta drejtoreshë, znj.A. B. (Shkresa me nr.193 prot., datë 06.08.2018).

Sikurse shihet nga aktet e mësipërme shkresore, është i njëjti person që ka bërë dhe emërimin dhe lirimin nga detyra të ankueses. Ajo ka qenë në dijeni të besimit të saj fetar, për shkak se mbulesa e saj e bën të evidentueshëm këtë fakt dhe vizualisht. Pra, pretendimi i ankueses se është larguar nga puna për shkak të besimit të saj fetar nuk qëndron, pasi ajo këto bindje i ka patur të ekspozuara që në marrjen e saj në punë në periudhë prove dhe në vijim. Për më tepër, drejtuesja e Qendrës, kishte vënë në dispozicion të ankueses dhe znj.I.B, me pozicion Punonjëse Sociale pranë kësaj qendre, një ambient të posaçëm për kryerjen e ritualeve fetare brenda qendrës.

Ndërsa, rezultoi e faktuar se dhe punonjësja që e ka zëvendësuar ka një fëmijë të moshës 1 vjeç dhe përgjegjësia prindërore nuk përbën shkak për trajtimin e pa barabartë të ankueses krahasuar me punonjësen e re që e ka zëvendësuar.

Sa i takon pretendimit të ankueses (të bëra prezent pas largimit të saj nga puna) për shpërdorim të detyrës dhe vjedhje të ndihmave të qendrës nga ana e drejtoreshës, theksojmë se ky pretendim duhet shqyrtuar nga organi përkatës, që është Prokuroria, e cila merr në shqyrtim kallëzimet penale. Në vijim të ankesës znj.E. M ka cituar se: *“...jam e mbuluar me shami dhe nuk jam bërë pjesë e abuzimeve dhe vjedhjeve, prandaj jam trajtuar në mënyrë të pabarabartë me të tjerët”*.

Komisioneri vëren se, shqyrtimi i këtij pretendimi nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në nenin 3/1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me*

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, znj.E. M nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pa barabartë, për këtë arsye nuk kemi cënim të nenit 3/1, dhe 7/1 të LMD-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj.E. M, nga ana e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Tiranë, për shkak të bindjeve të saj fetare dhe të përgjegjësisë prindërore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Besimi fetar, përgjegjësia prindërore
Fusha: Punësim